



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.5, datë 07.12.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SHOQËRISË “ERA HYDRO” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Era Hydro”, me adresë Njësia Administrative Pishaj Gramsh Qarku Elbasan sipas Miratimit Paraparak me Nr. 3647/5, datë 03.07.2017 “Për vazhdim procedure për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Blineta”, në lumin e Tomorricës, me derdhje në lumin Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan”, si dhe shtyrjes së afatit të vlefshmërisë së miratimit paraparak për hidrocentral “Blineta” me anë të shkresës me Nr. 9718/1 Prot., datë 17.01.2019 “Mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Miratimit Paraparak për hidrocentral “Blineta””. për shoqërinë “Era Hydro”.
2. Treguesit paraparak janë si më poshtë:
HEC Blineta
 - Prodhimi vjetor i parashikuar: 7.521.000 kwh/vit
 - Fuqia e instaluar: 1.980 kwh
 - Vlera totale e investimit: 399,418,456 lekë me TVSH.

Vendndodhja e veprës së marrjes/ burimi ujqor Lumi i Tomorricës

- $X=517253.6$; $Y=4515878.08$; $Z=262$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: $7.5 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore: $5.7 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: $1.21 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike: $0.6 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e Godinës së Centralit

- $X=515638.06$; $Y=4520827.84$; $Z=213$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: $7.5 \text{ m}^3/\text{s}$

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

